



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:235655
Datë: 10.03.2025
Numri i dokumentit: 06964096

Ac.nr.7888/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Nora Bllaca – Dula dhe Halide Reka, anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Fiton Haklaj, në çështjen juridike kontestuese të paditëses M.S nga V....., kundër të paditurit F.RR nga V....., me objekt të kontestit kompensimin e dëmit jo material dhe material, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, C.nr.303/2015, i datës 10.08.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 04.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e paditëses M.S nga V....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, C.nr.303/2015, i datës 10.08.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.303/2015, i datës 10.08.2022, ka vendosur si në vijim: “I. *REFUZOHET në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit M.S nga V....., kundër të paditurit F.RR nga V....., me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit – shpenzimeve të shtatzënisë për lindjen e djalit si dhe kompensimin e dëmit material dhe moral në shumë prej 4,000.00 Euro. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.*”

Kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, në Prishtinë, si gjykatë civile e shkallës së dytë ankesën e paditësit ta aprovojë si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të aprovojë kërkesëpadinë e paditëses, apo të njëjtin ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja me datë 10.08.2015 ka paraqitur padi, kundër të paditurit me objekt të padisë kompensimin e dëmit material dhe jo material, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të gjendjes faktike ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.303/2015, i datës 10.08.2022, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se nuk është kontetues fakti se ndërmjet palëve ka ekzistuar bashkësia (e kohëpaskohshme) jashtëmartesore (fakt që nuk mohohet nga palët); Nuk është kontestuese se fëmiu, M.S, ka lindur gjatë bashkësisë jashtëmartesore dhe baba biologjik i tij është i padituri; Nuk është kontestues fakti se palët kanë arritur pajtim gjyqësor lidhur me pagesën e alimentacionit për fëmion M.S. Në këtë çështje juridike, sipas gjykatës, kontestuese janë lëndimet e pësura nga paditësja ndërprerja e shtatzënisë me detyrim nga i padituri, pa pëlqimin e paditëses si dhe shpenzimet e shtatzënisë-lindjes. Sa i përket pretendimit të paditëses, se i padituri e ka detyruar që t'a heqë fëmion afërsisht dy muaj e gjysmë pas zënies, e njëjta nuk ka prezantuar asnjë provë, dhe nuk ka asnjë dokument në shkresat e lëndës me të cilën do të mund të vërtetohej pretendimi i paditëses. Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë raport mjekësor se një intervenim i tillë është kryer, kur kihet parasysh se intervenimet e tilla pas javës së 10 të shtatzënisë, mund të kryhet vetëm pas një vendimi të komisionit mjekësor dhe me pëlqimin e femrës shtatzënë, në të kundërtën një veprim i tillë do të mund të përbënte vepër penale për personat e përfshirë. Sa i përket pretendimit të paditëses, se paditësi, i ka shkaktuar lëndime në gishtin e këmbës, në kokë dhe në organe të brendshme (në mitër), e njëjta, nuk ka prezantuar asnjë provë më të cilën do të mund të vërtetoheshin pretendimet e paditëses. Në shkresat e lëndës nuk asnjë asnjë raport mjekësor me të cilin do të mund të provohej se paditësja ka pësuar lëndimet e mësipërme, për më tepër, nuk ka asnjë raport policor në shkresat e lëndës se paditësja ka lajmëruar rastin në polici dhe se nuk ka prova se është zhvilluar ndonjë procedurë penale kundër të paditurit në lidhje me pretendimin se i padituri i'a ka shkaktuar ato lëndime. Sa i përket pretendimit të paditëses në lidhje me shpenzimet e bëra lidhur me shtatzëninë-lindjen, e njëjta nuk ka paraqitur prova me të cilat do të mund të konstatoheshin shpenzimet e bëra nga paditësja me rastin e shtatzënisë-lindjes. Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë faturë, asnjë kupon fiskal me të cilat paditësja do të mund të argumentonte shpenzimet e bëra me rastin e shtatzënisë dhe lindjes. Tutje, në shkresat e lëndës ekzistojnë disa vendime nga Policia e Kosovës-Komisioni i Brendshëm Disiplinor, i cili ka zhvilluar hetime në lidhje me lajmërimet e paditëses kundër të paditurit, por që i padituri në të gjitha rastet në lidhje me lajmërimet e paditëses është shpallur i pafajshëm.

Vendimin lidhur me shpenzimet e morri konform nenit 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjyqimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e sidomos nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë si dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale dhe as shkelje tjera të pretenduara në ankesë.

Në vlerësimin e Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo sepse gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, përgjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe atë faktin se ndërmjet palëve ka ekzistuar bashkësia (e kohëpaskohshme) jashtëmartesore (fakt që nuk mohohet nga palët); nuk ka qenë kontestuese se fëmiu, M.S, ka lindur gjatë bashkësisë jashtëmartesore dhe baba biologjik i tij është i padituri si dhe nuk ka qenë kontestues fakti se palët kanë arritur pajtim gjyqësor lidhur me pagesën e alimentacionit për fëmijun M.S. Tutje, bazuar në vendimet nga Policia e Kosovës-Komisioni i Brendshëm Disiplinor si Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës i datës 29.05.2015; Vendimi nga Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës i datës 06.09.2021; Vendimi i Komisionit të Brendshme Disiplinor i datës 11.02.2016; Vendimi i Komisionit të Brendshme Disiplinor i datës 14.06.2018; Vendimi nga Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës i datës 06.05.2021; Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i datës 09.03.2018; Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i datës 09.12.2016; Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i datës 09.02.2016 dhe Vendimi i Drejtorisë Rajonale të Policisë Mitrovica-Jugu i datës 15.08.2016, i cili ka zhvilluar hetime në lidhje me lajmërimet e paditëses kundër të paditurit, por që i padituri në të gjitha rastet në lidhje me lajmërimet e paditëses është shpallur i pafajshëm. Po ashtu nga raportet mjekësore si Raporti i ordinancës “SH..... N.....” i datës 19.03.2021, Raporti i ordinancës i datës 04.08.2020 i përpiluar nga Dr. B.D dhe raportet tjera nga QKMF në V....., vërtetohet fakti se paditësja i është nënshtruar kontrolleve mjekësore për kokëdhembje.

Më tej edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur për zbatim të gabuar të drejtës materiale, të njëjtin Gjykata e Apelit, e vlerësoj në këtë drejtim sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se nga gjendja faktike e vërtetuar drejtë është aplikuar dhe e drejta materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses.

Dispozita e nenit 136 e LMD-së parasheh “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.*”, kurse neni 137 përcakton “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).*”

Neni 169 i LMD-së parasheh “1. *Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla.*”

Në kontekstin e dispozitave të lart cekura ligjore, dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e këtyre dispozitave të LMD-së, rezulton se ai që i shkaktën dëm tjetrit ka detyrim t’ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë rast nuk është plotësuar asnjëri nga këto kushte ligjore në mënyrë që të dalë përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit këtu paditëses.

Paditësja si fakt dëmtues në raport me fajin e të paditurit ka referuar faktin se i padituri ka detyruar të paditurën që ta heqë fëmijun afërsisht dy muaj e gjysmë pas zënies dhe se i ka shkaktuar lëndime në gishtin e këmbës, e që nga provat e administruara nuk është provuar si fakt, kjo sepse nga vendimet e Policisë së Kosovës është vërtetuar se këtu i padituri është liruar nga përgjegjësia disiplinore për rastet të cilat i ka iniciuar këtu paditësja.

Sa i përket dëmit të shkaktuar, paditësja me asnjë provë nuk ka vërtetuar faktin se e njëjta i është nënshtruar ndonjë intervenimi mjekësor për abortin e fëmijës edhe pse gjykatës i ka propozuar raporte mjekësore, të cilat i konsistojnë kontrolleve mjekësore për kokëdhimbje dhe jo për abort ashtu siç pa të drejtë pretendon paditësja.

Kjo gjendje faktike e cila nuk kualifikohet në raport me të drejtën materiale të lart cituar, përcakton pasojën juridike të vendosur në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjegjësisht refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses si të pabazuar.

Gjykata e Apelit, vlerësoj edhe pretendimet tjera të paditëses në raport me propozimet për prova të reja të cilat i ka lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo të njëjtat dalin si të pabazuara kjo sepse paditësi në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e vet sa i përket dëmit material dhe jo material edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2, e lidhur me neni 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ *Gjykata është e autorizuar ti vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuara në nenin 3 paragraf 3 të këtij ligji) në qoftë se me ligj nuk*

është përcaktuar ndryshe”, si dhe në kuptim të nenit 356 të LPK-së e cila përcakton se “Gjykata sipas propozimit të palëve apo sipas detyrës zyrtare, nxjerr provën me ekspertizë”.

Po ashtu LPK-ja në dispozitën e nenit 406 e cila përcakton *“406.1 Varësisht nga rezultati i shqyrtimit në seancën përgatitore gjykata do të vendos se çka do të jetë objekt shqyrtimi dhe cilat prova do të merren, në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.”*, në ndërlidhje me nenin 428 paragrafi 2 të LPK-së e cila parasheh *“428.2 Palët gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor mund të paraqesin fakte të reja, dhe të propozojnë prova të reja, vetëm po që se e bëjnë të besueshme rrethanën se pa fajin e tyre nuk kanë mundur t’i paraqesin, respektivisht propozojnë në seancën përgatitore.”*, si dhe në lidhje me nenin 180 paragrafi 1 të LPK-së e cila thekson *“1 Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë.”*, përcakton kufizimin që propozimet për prova jipen gjatë seancës përgatitore, kurse në seancën e shqyrtimit kryesor dhe me ankesë vetëm përjashtimisht në rast se pa fajin e tyre palët nuk ka mundur ti paraqesin përgjatë seancës përgatitore, ku në rastin konkret paditësja nuk ka vërtetuar elementin subjektiv të dispozitave të lartcituara, gjegjësisht pafajësinë e saj në mënyrë që propozimet e bëra të mund të ndikojnë në një vendimarrje ndryshe nga ajo siç është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ankimore i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore mirëpo gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7888/2022, me datë 04.03.2025.

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari

Faton Ademi, d.v